



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 710 prot

Tiranë, më 24.12 2024

VENDIM

Nr. 9 datë 24.12 2024

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 20/12/2024

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 20.12.2024 vendosi:

1. Për projekturdhërin “**Granti i Përformancës**”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Për planin e mbarështimit të gjendet një formulë e përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për bashkitë, duke patur parasysh nivelet e sipërfaqes pyjore që kanë disa prej bashkive.
  - Në Komisionet e Vlerësimit të përfshihet edhe Shoqata për Autonominë Vendore pasi ka eksperiencë në këtë drejtim duke qënë pjesë e komisioneve të ndryshme të vlerësimit.

2. Për projektvendimin “Për pjesëmarrjen e krijimit të personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
3. Për projektvendimin “Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkontinentare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për digjitalizimin e shërbimeve publike të qeverisjes lokale dhe sistemit të prokurimit digjital të fuqizuar nga inteligjenca artificiale në kuadër të programit ”Përmirësimi i aksesit universal në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet teknologjisë (Govtech)”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Të mbahet në vëmendje infrastruktura e dobët e bashkive si dhe të asistohen bashkitë për ngritjen e kapaciteteve.
  - Të sigurohet mirëmbajtja e infrastrukturës digitale.
4. Për projektvendimin “Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial”, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
5. Për projektvendimin “Për miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës në të cilat do lehojet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale”, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
6. Për projektvendimin “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Në periudhën e sezonit të ulët strukturat akomoduese janë të detyruara të paguajnë taksa ndërkohë që për shumë bashki në këtë periudhë, një pjesë e mirë e zonave bregdetare nuk kanë pushues apo turist;
  - Cikli turistik edhe brenda një zone bashkiake është e ndryshme dhe kjo duhet reflektuar në projektvendim me taksimin përkatës;
  - Sezoni i lartë dhe i ulët është i ndryshëm nëpër qytete të ndryshme;
  - Të vendoset një sistem që raporton në çfarëdo orari çdo turist që qëndron në strukturat akomoduese të atij qyteti dhe mbi bazën e këtij sistemi të vendoset edhe taksimi.
7. Për projektligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ që përfaqësojnë NJVV-të pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ **shprehën mosdakordësinë** me aktin

dhe kërkuan rishikimin e projektligjit dhe diskutimin e tij në mbledhjen e radhës për pikat si më poshtë:

- Neni 65 Pika 2, planifikimi vendor për pesë rrymat e përcaktuara si letra dhe kartoni, qelqi, metali dhe plastika. Mbetjet bio përbëjnë shqetësim lidhur me ngritjen e sistemit për grumbullimin e diferencuar të tyre;
- Neni 65 Pika 2, Grumbullimi dhe trajtimi sipas pesë rrymave, duhet trajtuar me kujdes mbi mënyrën se si do të zgjidhet ndarja në nivelin e njësive familjare dhe duhet të marrë në konsideratë kohën e nevojshme për ngritjen e sistemit në nivel vendor, të kapaciteteve të kufizuara financiare të NJVV për të ngritur sistemin, dhe të kapaciteteve të kufizuara njerëzore për t'a operuar dhe mirëmbajtur atë.
- Fondi i Ekonomisë së Mbetjeve nuk specifikon në mënyrë të vecantë mbështetjen për NjQV, të shtohet togfjalëshi specifikues "... në mbështetje të NJVV";
- Projektligji duhet të parashikojë hartimin dhe miratimin e standardit minimal të menaxhimit të mbetjeve në nivel e NJVV;
- Të përmbajë parashikimet për detyrimet që lindin për NJVV për menaxhimin e a) mbetje të rrezikshme shtëpiake dhe b) rrymave të tjera të mbetjeve: si mbetjet e rrezikshme, elektronike, makinat në fund të jetës që grumbullohen në territorin e bashkisë dhe duhet saktësuar detyrimi i NJVV lidhur me magazinimin e përkohshëm dhe transferrimin e tyre për trajtim të specializuar si dhe bashkia nuk ka staf teknik të mjaftueshëm dhe të përgatitur për të ngritur dhe menaxhuar një sistem MIM;
- Neni 11, Rikuperimi i mbetjeve nëse ka ndonjë parashikim apo financim në mënyrë që kjo faturë të jetë e përballueshme nga Qeverisja Vendore;
- Të mbështeten bashkitë me përballimin e kostove financiare për ngritjen e sistemit për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve;
- Neni 27, pika 2, të përcaktohet se si do të bëhet arkëtimi dhe si do t'i faturohet, kosto e shërbimit apo nëpermjet gjobave në rastet kur identifikohet ndotësi;
- Neni 28, Neni 29, Kostot për ngritjen e sistemit të MIM në nivel vendor duhen mbështetur me fonde të veçantë/specifikë prej nivelit qendor;
- Të parashikohet kontributi i nivelit qendor për mbullimin e një pjesë të shpenzimeve për këtë trajtimin fundor me mbulim të kostove të transportit dhe depozitimit;
- Neni 71, të përmbajë edhe detyrimin për raportimin e të dhënave të grumbulluara prej operatorëve të impjanteve fundorë tek bashkitë pjesëmarrëse në Zonën e Mbetjeve, sipas rrymave të përcaktuara;
- Të qartësohet në ligj dhe të specifikohet roli i AKEM dhe AKM lidhur me detyrimin e bashkive për raportimin e të dhënave për mbetjet;
- Të parashikohet në ligj vlerësimi i bashkive bazuar në përformancë dhe raportimin e të dhënave për treguesit e realizimit të saj;
- Të eliminohen vështirësitë në marrjen e informacioneve për planifikimin dhe menaxhimin në nivel zonal;
- Të qartësohet pronësia mbi impiantet fundore të trajtimit të mbetjeve, kur ato gjenden në territorin e një bashkie;
- Neni 77 pika 15, rrit masën e sanksionit ndaj Kryetarit për mos zbatim të Nenit 24: në draftin 1 ishte 650 000 – 1 300 000 lekë, ndërsa në draftin 2 bëhet 1 000 000 – 2 000 000 lekë;
- Të vendosen penalitete edhe ndaj operatorëve të impjanteve fundorë të trajtimit të mbetjeve, të cilët vonojnë apo nuk japid dhe nuk përbushin detyrimin për të dhënë informacion tek bashkitë;
- Neni 48, Kostot e trajtimit të mbetjeve bio janë më të larta sesa përfitimi ekonomik

- prej shitjes së produktit pas trajtimit të mbetjeve bio si dhe vështirësi në kontrollin e territorit lidhur me depozitimin ose hedhjen jo të rregullt/paligjshme të mbetjeve të rrezikshme prej operatorëve të ndryshëm;
- Të specifikohet në mënyrë të veçantë trajtimi i mbetjeve kimike bujqësore, të cilat përzihen me mbetjet bashkiake apo hidhen në territor;
  - Neni 29, pika 2, germa a), duhet qartësuar dhe specifikuar mënyra e mbledhjes së kundravajtjeve administrative, për shkak të mungesës së sistemit, mungesës së identifikimit të ndotësve.
8. Për projektvendimin **“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Specializimit Inteligjent (S3) 2025-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj”**, propozuar nga Kryeministria bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
9. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe një ndryshim në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë”** propozuar nga Kryeministria bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, u shprehën parmisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
- Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përbajtje: “2/1. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Rinisë, financohet: a) nga bashkia, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”. Ky lapsus duhet edituar pasi sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore ku bashkitë mbulojnë me kosto vetëm Këshillat Vendor Rinor.
10. Për projektligjin **“Për vullnetarizmin”** propozuar nga Kryeministria bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, u shprehën parmisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
- Ministria e Financës të kalojë zërin përkatës tek pushteti vendor nëse ky projektligj impakton financat vendore
11. Për projektligjin **“Për përformancën energjitike të ndërtesave”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
12. Për projektvendimin **“Për miratimin e strategjisë afatgjatë të rinvimit të stokut të ndërtesave”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
13. Për projektvendimin **“Për miratimin e Programit të Veprimit 3-vjeçar, për vitet 2025-2027, në zbatim të Strategjisë Minerare”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.

14. Për projektvendimin “**Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për përkatesinë e përsonave në një pakicë kombëtare**” propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
15. Për projektvendimin “**Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet përsonave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore**” propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
16. Për projektvendimin “**Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkесës për njohjen e një pakice kombëtare**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.

Z. Aldrin DALIPI  
Kryetar i Shoqatës së Këshillit e Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar

Z. Arbjan Mazniku  
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor  
Bashkëkryetar

Me urdhër dhe delegim

Z. Ermal Elezi  
Drejtor i Përgjithshëm  
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

